

V E N D I M
Nr.469, datë 6.10.1999

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E AGJENCISË TELEGRAFIKE SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8439, datë 29.12.1998 “Për buxhetin e shtetit të vitit 1999”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Agjencisë Telegrafike Shqiptare t’i akordohet një fond shtesë nga buxheti i vitit 1999 prej 2 500 000 (dymilionë e pesëqind mijë) lekësh, nga të cilat 500 000 (pesëqind mijë) lekë për fond page dhe 2 000 000 (dy milionë) lekë për shpenzime operative.
 2. Efektet financiare të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Agjencia Telegrafike Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare,

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko